VENDIM
Nr. 57, datë 10.3.2025

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN SHKURT 2025, PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; dhe të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.3.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1228/1 prot., datë 7.3.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, "Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shkurt 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV",

konstatoi se:

- "FSHU" sh.a., me shkresën nr. 1069 prot., datë 28.2.2025, protokolluar me tonën me nr. 1228 prot., datë 3.3.2025, ka depozituar në ERE kërkesën mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin shkurt 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Bazuar në aplikimin e sipërcituar, për muajin shkurt 2025 shoqëria "FSHU" sh.a. e ka siguruar sasinë e energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës për energji të kësaj kategorie klientësh nëpërmjet blerjeve mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX).

- Për përllogaritjen e çmimit mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike për këtë periudhë (ÇBEt), "FSHU" sh.a. është bazuar në blerjet ditore/mujore të saj në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike për muajin shkurt 2025, profilet ditore të prokuruara në Bursë, çmimin ditor/orar, si dhe vlerën e faturës ditore.

- Referuar të dhënave të mësipërme, rezulton se çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt) i përllogaritur nga shoqëria për muajin shkurt 2025 është 15.82 lekë/kwh. Për efekt kontrolli të të dhënave të paraqitura, u konsiderua e arsyeshme rillogaritja e tyre, nga e cila rezultoi se mesatarja e ponderuar e çmimit të blerjes së energjisë elektrike është 15.82 lekë/kwh.

- Mbështetur në nenin 8, të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shkurt 2025 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes, si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.

- **Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike** për periudhën 1 shkurt 2025–31 dhjetor 2027, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 279, datë 16.12.2024, është *0.85 lekë/kwh.*

- **Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV**, në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 288, datë 23.12.2024, "Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022", është 1.55 lekë/kwh.

- **Kostot administrative,** prej 1.06 lekë/kwh.

- **Kurset zyrtare të këmbimit të publikuara nga Banka e Shqipërisë (lekë/euro),** për çdo datë respektive të harkut kohor 31.1.2025–27.2.2025.

- Në zbatim të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", referuar aplikimit të "FSHU" sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet

e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shkurt 2025, përllogaritet si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin shkurt 2025			
		Njësia	*Çmimi*
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë	Lekë/kWh	15.82
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin	Lekë/kWh	0.47
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundi	Lekë/kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	1.55
*Çmimi i energjisë = CBEt + Pr * CBEt + TRr + TSHt + CA*		*Lekë/kWh*	*19.76*

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë 19.76 lekë/kwh për muajin shkurt 2025.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shkurt 2025 prej 19.76 lekë/kwh, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Ndryshimi i secilit element përbërës në llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për kategoritë e klientëve të cilësuar në këtë vendim, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga Bordi i ERE-s.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti